



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
- Kuvendi i Komunës-
01Nr. 16- 6293/2012
Kaçanik, 04.04.2012

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në bazë të nenit 17 (f) lidhur me nenet 11, 12.2 dhe 40 e Ligjit nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28 e datës 04 qershor 2008), nenit 34.5 lidhur me nenin 6 të Statutit të Komunës, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 04.04.2012, mori këtë:

VENDIM
PËR KUFIZIMIN E OFËRIMIT TË SHËRBIMEVE
MË PAGESËN E FATURAVE PËR UJË

I.

Me këtë Vendim, përcaktohen llojet e shërbimeve komunale që kufizohen nga organet e administratës komunale të komunës së Kaçanikut, për shkak të mos pagesës së faturave të ujit.

II.

Kufizimi i ofrimit të shërbimeve komunale nënkupton, mosofërimin e shërbimeve të lidhura më pronën, biznesin, tenderët dhe ndërtimin, nese personi fizik dhe juridik nuk i paguan faturat e ujit.

Ofërimi i shërbimeve në kuptim të këtij vendimi, do të iu ofrohet të gjithë personave fizik dhe juridik, të cilët paguajnë shumën prej 40% nga borgji i përgjithshëm.

III.

Shërbimet e kufizuara përfshijnë:

1. Dokumentet pronësore, kadastrale dhe gjeodezike,
2. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,
3. Lejen për shfrytëzimin e pronës komunale,
4. Taksën e automjeteve motorike,
5. Lejen e punës për veprimtaritë biznesore, lejet e punës për veprimtaritë profesionale dhe lejet e përkohshme të parapara me rregulloret komunale,
6. Tenderët e publikuar nga Zyra e Prokurimit,
7. Kushtet urbanistike, lejet për ndërtim, pranim teknik të objekteve dhe lejet për demolim.

IV.

Kufizimi i ofrimit të shërbimeve sipas këtij vendimi nuk do të zbatohet vetëm ndaj personave fizik që janë në asistencë sociale, Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Veteranëve të Luftës së UÇK-së.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën drejtoritë e administratës komunale.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

VII.

Me këtë Vendim njoftohet:

1. Kryetari i komunës,
2. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe nepërmjet kësaj Drejtorie njoftohen organet tjera relevante,
3. Arkiva.

Kryesuesi i kuvendit,
z. Xhelal Gashi
